




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.100/2022  
Datë: 24 shkurt 2022

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Drana Simani, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega në Viti, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK /11/ 2021/ GJTHGJL - ADGJTHGJL.nr.03 /2021, të datës 07.02.2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 24 .02.2022, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

**Drana Simani**, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Viti, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.2, lidhur me paragrafin 1, pika 1.3 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

#### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje “Këshilli”), me 01.12.2021 ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoritet Kompetent me pretendim së Drana Simani, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Viti, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5-shkeljet disiplinore për gjyqtarë, paragrafi 2, pika 2.2-nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitaret dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë, lidhur me paragrafin 1, pika 1.3-shkel detyrat e tij zyrtare si gjyqtar, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent, të fillojë hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtës, në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t’i shqiptohet njëri nga sanksionet disiplinore të parapara sipas nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

Kërkesës së cekur më lartë, Autoriteti Kompetent ia ka bashkangjitur ankesën e ankuesit \_\_\_\_\_ të datës 12.11.2021; Deklaratat e gjyqtares Simani, avokatit \_\_\_\_\_ dhe zyrtares ligjore \_\_\_\_\_ të datës 17.11.2021; Procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 04.11.2021 për rastin penal të evidentuar me numër P.nr.284/2019; Aktgjykimin me numër P.nr.284/2019, të datës 05.11.2022.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.405/2021, të datës 08.12.2022, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/11/2021/GJTHGJL-AD/GJTHGJL.nr.03/2021.Paneli Hetimor, 07.02.2022 i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit të Panelit Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, Këshilli me datë 24.02.2022, ka mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor gjyqtari Beqir Kalludra dhe subjekti i hetimit disiplinore, gjyqtarja Drana Simani.

Kryesuesi i Panelit Hetimor, bazuar në Ligjin Nr.06/l-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore më datë 21.01.2022, në të cilën është ftuar subjekti i hetimit disiplinor. Paneli Hetimor ka gjetur fakte të pakontestuara lidhur me datën dhe kohën e mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, në të cilën ushtruesi i ankesës disiplinore nuk është paraqitur në fillimin e shqyrtimit gjyqësor për çështjen penale P.nr.284/2019.

Kjo rrethanë nga Paneli Hetimor, është vërtetuar në radhë të parë nga ftesa për shqyrtim gjyqësor, e datës 15.10.2019 për të dëmtuarin \_\_\_\_\_ nga e cila rezulton se të dëmtuarit i është dërguar ftesa në mënyrë të rregullt dhe me kone ane nga deklaratat e subjektit hetimor të dhënë për Autoritetin Kompetent më datë 17.11.2021. Subjekti i hetimit disiplinor në deklaratën e dhënë për Autoritetin Kompetent ndër të tjera ka theksuar se seanca gjyqësore ka qenë e caktuar me 04.11.2021, me fillim në ora 9:00, ku kanë qenë të ftuara të gjitha palët në procedurë. Me 04.11.2021, në ora 9:00 palët janë lajmëruar në recepcion të gjykatës, mirëpo për shkak të njoftimit për vonesë nga ana e prokurores së kësaj çështje penale, palëve prezentë në gjykatë, përmes recepcionit janë njoftuar se shqyrtimi gjyqësor do të shtyhet për 40 minuta. Seanca ka filluar në ora 9:40 minuta, prezent kanë qenë prokurorja \_\_\_\_\_ i akuzuari \_\_\_\_\_ dhe mbrojtësi i tij avokat \_\_\_\_\_ ndërsa pala e dëmtuar nuk kanë qenë prezentë.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë seanca e shqyrtimit gjyqësor ka përfunduar në ora 10:10 minuta. Deri sa palët kanë qenë ende në sallë duke e nënshkruar procesverbalin, kanë hyrë në sallë dy meshkuj dhe një femër, të cilët sipas deklaratës së gjyqtarës Simani nuk i ka njohur. Të njëjtit pas prezantimit gjyqtarja Simani i kishte njoftuar se shqyrtimi gjyqësor kishte përfunduar. Sipas gjyqtarës Simani ka qenë pikërisht ankuesi i këtij rasti disiplinor, si palë e dëmtuar në këtë çështje penale dhe avokatja e tij qe janë sjellë në mënyrë shume agresive në raport me gjyqtaren.

Këtë gjendje faktike, Paneli Hetimor e ka vërtetuar edhe me deklaratën e zyrtarës ligjore të gjyqtarës Drana Simani, dhe të recepcionistit të gjykatës. Lidhur më këtë çështje është deklaruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit G.T. avokati \_\_\_\_\_ i cili për Panelin Hetimor ka dhënë deklaratë të njëjtë më atë të gjyqtarës Simani.

Paneli Hetimor, raportit mbi faktet dhe provat e mbledhura ja ka bashkangjitur provat: Deklaratat e gjyqtarës, Drana Simani, subjekt të këtij hetimi disiplinor, zyrtarës Ligjore të gjyqtarës Simani, mbrojtësit të të akuzuarit avokatit \_\_\_\_\_ Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datë 04.11.2021; Aktgjykimin P.nr.284.2019, itesat për shqyrtim gjyqësor të datës 15.10.2021 për të dëmtuarin \_\_\_\_\_ Librin e evidencës së të lajmëruarve ne recepcion me datë 04.11.2021 të orës 9:00.

Nga gjykata, Paneli Hetimor ka pranuar librin e evidencës me personat e lajmëruar në gjykatë më datë dhe orën të cekur si me lartë. Nga kjo provë është vërtetuar fakti se i dëmtuari, (ankuesi i këtij rasti disiplinor) është lajmëruar në gjykatë në ora 9:00, por nuk është vërtetuar nga Paneli Hetimor se i niëiti a është lajmëruar në gjykatë edhe me përfaqësuesen e autorizuar të të dëmtuarës \_\_\_\_\_ por është vërtetuar vetëm prezenca e \_\_\_\_\_ motrës

Paneli Hetimor i ka dorëzuar për shqyrtim dhe vendimmarrje KGJK-së këtë raport me faktet dhe provat e mbledhura për të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga gjyqtarja Drana Simani gjatë procedimit të lëndës P.nr.284/2019.

Gjyqtarja Simani në seancën dëgjimore të Këshilli të mbajtur me datë 24.02.2022, deklaroi se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se me rastin e procedimit të lëndës penale P.nr.284/2019, të ketë bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, shkeljet disiplinore për gjyqtarë, paragrafi 2, pika 2.2-nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitaret dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë, lidhur me paragrafin 1, pika 1.3-shkel detyrat e tij zyrtare si gjyqtar, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë palët në procedurë penale gjyqësore, e qe në rastin konkret të dëmtuarin.

Sipas gjyqtares Simani seanca përkatëse ka qenë e caktuar me datë 04.11.2021, prej orës 9:00. Palët kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt, gjë qe është vërtetuar edhe përmes flet kthesave, që gjenden edhe në shkresat e kësaj lëndë disiplinore. Me datë 04.11.2022 në ora 9:00, gjyqtarja Simani ishte njoftuar nga recepcioni i gjykatës qe palët kanë ardhur dhe janë duke pritur te recepcioni. Meqenëse prokurorja e çështjes ka lajmëruar se do të vonohet për 40 minuta, dhe duke marrë parasysh qe i akuzuari në këtë rast kishte ardhur nga Zvicra, gjyqtarja Simani deklaroi se nuk e ka shtyrë seancën, por i ka thënë zyrtarit në recepcion, qe palët të presin për shkak se prokurorja e çështjes po vonohet. Gjyqtarja Simani e ka mohuar në tërësi pretendimin e parashtruesit të ankesës se nuk e kishte lejuar të dëmtuarin të presin të salla e gjykimit.

Shqyrtimi gjyqësor për rastin përkatës ka filluar në ora 9:40, dhe me qe i akuzuari kishte pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar në ora 10:10 minuta. Deri sa palët prezentë kanë qenë duke nënshkruar procesverbalin, ishte lajmëruar pala e dëmtuar dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar. Në këtë situatë, gjyqtarja Simani ka deklaruar se e kishte njoftuar palën e dëmtuar, se shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar, do ta marrin vendimin dhe kanë të drejtën e ushtrimit të ankesës.

Për t'i vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: Deklaratat e gjyqtares, Drana Simani, subjekt të këtij hetimi disiplinor, zyrtares Ligjore të gjyqtares Simani, mbrojtësit të të akuzuarit Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datë 04.11.2021; Aktgjykimin P.nr.284.2019, ftesat për shqyrtim gjyqësor të datës 15.10.2021 për të dëmtuarin Librin e evidencës së të lajmëruarve në recepcion me datë 04.11.2021 të orës 9:00; Procesverbalin e seancës dëgjimore të Panelit Hetimor të mbajtur me datë 14.01.2022 dhe Transkriptin e Panelit Hetimor nga seanca dëgjimore e mbajtur me 21.01.2022.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit gjyqtares Drana Simani, Këshilli në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 24.02.2022, konstatoi se gjyqtarja Simani, me rastin e procedimit të çështjes penale të evidentuar me numër P.nr.284.2019, nuk ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.2, lidhur me paragrafin 1, pika 1.3 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli ka gjetur se gjyqtarja Simani nuk është përfshirë në shkeljen disiplinore gjatë shqyrtimit gjyqësor për çështjen penale P.nr.284.2019, siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent. Bazuar në deklaratën e gjyqtares Simani, të gjeturat e Panelit Hetimor si dhe provat e bashkangjitura këtij raporti, Këshilli ka konstatuar se për çështjen penale përkatëse P.nr.284/2019, gjyqtarja Simani shqyrtimin gjyqësor e kishte caktuar me datë 04.11.202, prej orës 9:00. Për këtë çështje penale ftesat palëve ju ishin dërguar në mënyrë të rregullt. Ka vlerësuar se gjyqtarja Simani, në procedimin e çështjen penale P.nr.284/2019, kishte vepruar në përputhje me dispozitat ligjore. Në të njëjtën datë palët ishin lajmëruar tek recepcioni i gjykatës. Për shkak të vonësës së prokurores

së çështjes, gjyqtarja Simani kishte kërkuar përmes telefonit nga recepcioni që të njoftohen palët për vonesën e prokurores dhe të njëjtit të presin sepse shqyrtimi gjyqësor do të mbahet. Këtë shtyrje të shqyrtimit gjyqësor për 40 minuta, sipas vlerësimit të Këshillit gjyqtarja Simani e kishte bërë në mënyrë që shqyrtimi të mos të shtyhet për një datë tjetër dhe marrë parasysh që i akuzuari për shqyrtimin gjyqësor ishte ardhur nga një shtet Zvicra, pra nuk jetonte në Kosovë.

Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar në ora 9:40 minuta dhe prezent kanë qenë prokurorja e shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij. Përpara se ta filloj shqyrtimit gjyqësor, nga Këshilli është vërtetuar se gjyqtarja Simani kishte thirrë edhe një herë recepcionin dhe e ka pyetur se mos është duke pritur edhe pala e dëmtuar. Nga recepcioni i gjykatës ishte njoftuar se të njëjtit kanë shkuar. Me që gjatë shqyrtimit i akuzuari e kishte pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësor përfunduar në ora 10:10 minuta. Këshilli ka konstatuar se në momentin që palët prezentë kanë qenë duke e nënshkruar procesverbalin, kishte hyrë në sallë pala e dëmtuara se bashku me avokaten.

Këshilli ka konstatuar se gjyqtarja Simani e kishte njoftuar palën e dëmtuar se shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar dhe do ta marrin vendimin, ndaj të cilit kanë të drejtë ankese. Në bazë të deklarimeve të gjyqtarës Simani, ka qenë ankuesi si palë e dëmtuar në këtë çështje penale që se bashku me avokaten në raport me gjyqtaren Simani kanë qenë agresiv.

Shkeljet e pretenduara nga Autoriteti Kompetent nuk janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor. Ky raport është vlerësuar si i besueshëm pasi Paneli Hetimor në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve.

Këshilli në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime vendosi se gjyqtarja Drana Simani nuk është përgjegjëse për shkelje disiplinore siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent dhe të njëjtën e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.100/2022, datë: 24 shkurt 2022**

Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Ramiz Azizi, Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan;
- Drana Simani, Gjyqtare e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti;
- Arkivit.